

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për vullnetarizmin”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr.692, datë 26.10.2022 “Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe plani i veprimit 2022-2029”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	18.11.2024 - 16.12.2024
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	23.06. 2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025- MSHRF – Nr.1 VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Oltion Pengu oltion.pengu@kryeministria.al Nr. tel: 0684037864 SaraKapoli, sara.kapoli@kryeministria.al Nr. tel: 0696636653

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Ligji ekzistues Nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, ka dëshmuar mangësi të theksuara në zbatimin e tij praktik, duke frenuar potencialin e plotë të vullnetarizmit në Shqipëri. Problemi buron nga disa aspekte strukturore të ligjit që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ofruesit, vullnetarët dhe përfituesit e vullnetarizmit.

Shkaqet e Problemit

Disa nga shkaqet kryesore që kanë sjellë këtë situatë janë:

1. Rregullime të pamjaftueshme dhe përkufizime të paqarta ligjore: Ligji aktual ofron përkufizime të paqarta dhe jo të standardizuara të vullnetarizmit dhe si rrjedhojë ka

sjellë konfuzion në dallimin midis marrëdhënieve vullnetare dhe formave të tjera juridike, si punësimi.

2. Mungesa e mekanizmave mbështetës dhe monitorues: Aktualisht, nuk ekziston një sistem i centralizuar funksional për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve vullnetare në nivel kombëtar, pavarësisht parashikimeve ligjore për krijimin e një regjistri të tillë. Kjo mungesë ka sjellë vështirësi në evidentimin dhe dokumentimin e organizatave që ofrojnë veprimtari vullnetare, si dhe të vetë vullnetarëve të përfshirë në këto procese. Si rrjedhojë, ka krijuar mungesë transparence dhe llogaridhënie.
3. Pjesëmarrje e ulët për shkak të mungesës së stimuljeve: Vullnetarizmi nuk njihet si përvojë e vlefshme profesionale, gjë që dekurajon pjesëmarrjen e të rinjve dhe grupeve të tjera.
4. Mbrotjtje e pamjaftueshme për vullnetarët: Nuk janë parashikuar masa të plota për sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen, duke krijuar pasiguri për individët që angazhohen në aktivitete vullnetare.
5. Promovim dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm: Nuk ekzistojnë fushata sistematike për të promovuar vlerat dhe përfitimet e vullnetarizmit në nivel kombëtar.

Nevoja për Ndërhyrjen e Qeverisë:

Ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për të përmirësuar kuadrin ligjor që rregullon vullnetarizmin dhe për të garantuar që çdo individ, veçanërisht të rinjtë, të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar, zhvilluar aftësi dhe përfituar nga angazhimi qytetar. Aktualisht, kuadri ligjor ekzistues nuk ofron mbrotjtje dhe mbështetje të mjaftueshme për vullnetarët, duke përfshirë dhe vullnetarët që i përkasin grupeve të veçanta.

Ndërhyrja e qeverisë do të ndihmojë gjithashtu në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë praktikën më të mira të Bashkimit Evropian në fushën e vullnetarizmit. Përmes ndryshimit të ligjit, Shqipëria do të mund të krijojë një kuadër të fortë ligjor që garanton mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të vullnetarëve në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

1. Përmirësimi në tërësi të kuadrit ligjor të vullnetarizmit në Shqipëri përmes:

- prezantimit të koncepteve dhe parimeve bazë për vullnetarizmin që lejojnë përcaktimin e konceptit ligjor të vullnetarizmit, si dhe elementëve përbërës së tij, duke mundësuar dallimin e marrëdhënieve vullnetare për efekt të zbatimit, nga marrëdhënie të tjera juridike, si marrëdhëniet e punës apo marrëdhëniet e shërbimit.
- rritja e qartësisë dhe harmonizimit të kuadrit ligjor të zbatueshëm në këtë fushë brenda vitit 2025.;

-
- vendosjes së rregullimeve ligjore për organizimin dhe monitorimin e vullnetarizmit, si dhe për angazhimin, sigurimin dhe regjistrimin e vullnetarëve që harmonizohen me format e ndryshme të veprimtarisë vullnetare.
- parashikimit të rregullave të posaçme për kryerjen e vullnetarizmit, duke përfshirë garanci të shtuara për mbrojtjen e të drejtave të vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit që i përkasin grupeve të veçanta.
- parashikimit të kontratës së vullnetarizmit dhe elementëve përbërës së saj.
- parashikimit të rregullave për vullnetarizmin që nga natyra dhe specifikat e tij nuk mund të formalizohet përmes kontratës së vullnetarizmit.
- përcaktimi të të drejtave dhe përgjegjësi të vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarit në marrëdhënien e vullnetarizmit.
- parashikimit të llojit të sigurimit me të cilin ofruesi i vullnetarizmit do të mbulojë vullnetarin si dhe procedurat e deklarimit të tij, në përputhje me parimin e sigurisë juridike.
- parashikimit të kodit të etikës së vullnetarit, duke përcaktuar rregullat e pranueshme të sjelljes për vullnetarin, ofruesin e vullnetarizmit dhe përfituesit të vullnetarizmit.
- ngritjen, administrimin dhe mënyrën e përdorimit të Regjistrit Elektronik për vullnetarizmit, si dhe përcaktimin e regjistrit të vullnetarizmit që mbahet dhe plotësohet nga ofruesi i vullnetarizmit.
- parashikimin e rregullave për lëshimin dhe plotësimin e librezës së vullnetarit.
- parashikimit të sanksioneve administrative të posaçme për shkeljet e detyrimeve të ligjit, në përputhje me parimin e sigurisë juridike.

2. Prezantimi i instrumentave ligjorë që synojnë nxitjen e pjesëmarrjes së individëve në vullnetarizëm dhe rritjen e veprimtarive vullnetare në vend, ku përfshihen:

- përcaktimi i konceptit të edukimit mbi vullnetarizmin dhe sigurimin e mbështetjes së posaçme të fëmijëve dhe të rinjve për fitimin e përvojës dhe kompetencave vullnetare.
- njohjen e vullnetarizmit si përvojë pune, për efekt të procedurave të rekrutimit të punëmarrësve brenda vendit.
- ngritja e programeve të dedikuara për promovimin, nxitjen dhe mbështetjen veprimtarive vullnetare në vend, ku përfshihen:
 - a) Çmimet Kombëtare për Vullnetarët e Vitit, për vlerësimin e kontributeve të dhëna për vullnetarizëm dhe promovimin e vullnetarizmit në vend dhe akordimin e një shpërblimi financiar.

b) Financimi i programeve të vullnetarizmit, duke ngritur një mekanizëm konkurrues mbështetje për ofruesit e vullnetarizmit, përmes subvencionimit të kostove të zbatimit të një programi vullnetarizmi c) Platforma elektronike e vullnetarizmit, si një hapësirë e dedikuar interaktive në portalin zyrtar të punësimit dhe aftësive, që do të shërbejë për promovimin e vullnetarizmit dhe ndërlidhjen mes ofruesve të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, në zbatimin e programeve apo veprimtarive vullnetare konkrete.

- kompensimi nga shteti i kontributit të paguar nga ofruesi i vullnetarizmit për sigurimin nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të vullnetarit.
- prodhimin e statistikave zyrtare mbi vullnetarizmin dhe mbledhjen e të dhënave administrative për të matur kontributin e vullnetarizmit në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, duke plotësuar hendekun e tanishëm në informacion dhe krijuar kushtet për një orientim më të drejtë dhe efektiv të politikave publike në këtë fushë..
- përcaktimit të detyrave të posaçme për institucionet publike qendrore dhe vendore në fushën e punësimit, arsimit të përgjithshëm dhe profesional, rinisë, përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, mbështetjes së shoqërisë civile që do të ndikojnë në promovimin, nxitjen dhe mbështetjen e vullnetarizmit në vend.
- rritjes së efektivitetit dhe uljes së kohës në përfitimin e shërbimeve publike të lidhura me vullnetarizmin, për ofruesit të vullnetarizmit dhe vullnetarët, përmes riinxhinierimit të këtyre dhe kalimit në format plotësisht elektronik.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: – Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues e konkretisht me ligjin nr. 46/2016 “Për Vullnetarizmin”. Pra ruajtja “status quo”-së (duke mos ndërhyrë me ndryshime, në ligjin ekzistues dhe duke mos hartuar një projektligji të ri).

- **Avantazhet:**

- Nuk krijon kosto shtesë financiare për institucionet publike.
- Nuk kërkon burime të reja për ndryshime të kuadrit rregullator dhe administrativ.

- **Disavantazhet:**

- Problemet aktuale si përkufizimet e paqarta dhe mungesa e mekanizmave mbrojtës mbeten të pazgjidhura.
- Nuk përmirëson as regjistrimin, as monitorimin e aktiviteteve vullnetare.
- Kufizon përfshirjen dhe promovimin e personave që i përkasin grupeve të veçanta.

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit aktual, pra i ligjit “Për Vullnetarizmin”.

- **Avantazhet:**

- Përmirëson kuadrin ligjor ekzistues me ndryshime të shpejta dhe praktike.
- Redukton disa pengesa administrative për organizatat dhe vullnetarët.
- Siguron mbrojtje më të madhe për vullnetarët përmes sigurimit shëndetësor dhe masave të tjera mbështetëse.

- **Disavantazhet:**

- Krijohet nevoja për ndryshime të mëtejshme në të ardhmen, duke shtuar kompleksitet në zbatimin e politikave.
- Ndryshimet prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit aktual, duke e bërë të papërshtatshëm.

Opsioni 2: (i preferuar) Shfuqizimi i ligjit aktual dhe miratimi i projektligjit të ri “Për Vullnetarizmin”.

- **Avantazhet:**

- Ofron një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe moderne që trajton në mënyrë të plotë sfidat ekzistuese.
- Siguron mekanizma të rinj dhe të avancuar për mbrojtjen dhe monitorimin e vullnetarëve.
- Promovon edukimin dhe ndërgjegjësimin për vlerat e vullnetarizmit, duke përfshirë masat për integrimin e personave që i përkasin grupeve të veçanta.
- Përputhet me rekomandimet e BE-së dhe ndihmon në ndërtimin e një mjedisi më të favorshëm për shoqërinë civile dhe solidaritetin shoqëror.

- **Disavantazhet:**

- Kërkon më shumë kohë dhe burime për hartimin dhe implementimin.
- Mund të krijojë sfida në tranzicionin nga legjislacioni ekzistues në ligjin e ri.

Opsioni 3: Ndërhyrja nëpërmjet masave jorregullatore

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në veprimtari vullnetare;
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për organizatat e shoqërisë civile që të përfshijnë të rinjtë në veprimtari vullnetare;
- Edukimi nëpërmjet organizimit të trajnimeve për qytetarët mbi të drejtat e tyre, mundësitë për përfshirje sociale dhe politike, si dhe përfitimet nga angazhimi në organizata rinore.
- Nxitja e bashkëpunimit midis qeverisë, organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit privat për të krijuar mundësi të qëndrueshme për vullnetarizëm dhe për të mbështetur nisma që angazhojnë të rinjtë në veprimtari vullnetare.
- Nxitja e pjesëmarrjes në nivel vendor.

Përfundim:

Opsioni 2 (Shfuqizimi i ligjit aktual dhe miratimi i projektligjit të ri “Për Vullnetarizmin”) siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë për rregullimin e vullnetarizmit, duke adresuar të gjitha sfidat dhe duke krijuar një kuadër të qëndrueshëm dhe të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve vullnetare.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike

Vënia në zbatim e opsionit të preferuar do të shoqërohet me ndikime ekonomike.

Projektligji shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e Institucionit përgjegjës për punësim dhe aftësim ku pagesat nga buxheti i shtetit për financimin e programeve të vullnetarizmit dhe çmimet për vullnetarët e vitit parashikohet të fillojnë në vitin 2026. Janë parashikuar shpenzime në masën 25,440,000 lek që do të përdoren kryesisht për përshtatjen sistemit të shërbimeve të punësimit me qëllim përfshirjen e funksionalitete të Regjistrat Elektronik për Vullnetarizmin, gjithashtu edhe rimbursimi I sigurimit të aksidenteve dhe semundjeve profesionale për 1000 vullnetare, financimin e programeve të vullnetarizmit dhe çmimet e vullnetareve të vitit. Financimi për periudhën 2025-2027 është planifikuar brenda taveve të programit “Tregu i Punës”, me shuma të miratuara për çdo vit.

Projektligji “Për vullnetarizmin” pritet të ketë ndikime ekonomike pozitive, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë lokal, të cilat përfshijnë:

1. Përmirësimi i kuadrit institucional dhe juridik:

- Ligji i ri krijon një kuadër të qartë për rregullimin e vullnetarizmit, duke shmangur konfuzionin ligjor dhe reduktuar kostot administrative për organizatat ofruese. Ky ndikim do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit dhe reduktimin e pengesave për zhvillimin e aktiviteteve vullnetare.

2. Rritja e përfshirjes sociale dhe solidaritetit shoqëror:

- Ligji i ri pritet të stimulojë angazhimin e grupeve të veçanta, të rinjve në aktivitete vullnetare. Kjo ndikon pozitivisht në zhvillimin e kapitalit social dhe fuqizimin e grupeve të veçanta.

3. Rritja e mundësive për zhvillim profesional dhe ekonomik:

- Njohja e përvojës vullnetare si përvojë pune mund të ndihmojë individët të përfitojnë aftësi të reja dhe të integrohen më lehtë në tregun e punës. Ky ndikim përmirëson mundësitë për punësim, veçanërisht për të rinjtë.

Ndikimet mbi bizneset**• Pozitive:**

- Reduktimi i kostove administrative për bizneset dhe organizatat që ofrojnë aktivitete vullnetare, falë thjeshtimit të procedurave për regjistrim dhe monitorim.
- Krijimi i një kuadri ligjor që garanton qartësi për përdorimin e vullnetarëve në aktivitete që kontribuojnë në përgjegjësinë sociale të biznesit.

• Negative:

- Disa biznese që përdorin vullnetarizmin si pjesë e veprimtarive të tyre mund të përballen me kosto të reja për respektimin e masave mbrojtëse (p.sh., sigurimet për vullnetarët).

Përfitimet afatgjata

- Rritja e volumit dhe cilësisë së aktiviteteve vullnetare në vend do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Në veçanti, përfitimet afatgjata përfshijnë:
 - Rritja e angazhimit qytetar përmes përfshirjes së më shumë individëve në aktivitete të strukturuar.
 - Përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe të burimeve të kualifikuara në tregun e punës.
 - Promovimin e kulturës së solidaritetit dhe qytetarisë aktive në shoqërinë shqiptare.

Ligji i ri pritet të sjellë një ndikim pozitiv të ndjeshëm, duke balancuar kostot fillestare me përfitimet sociale, ekonomike dhe institucionale në periudhën afatgjatë.

Ndikimet sociale

Projektligji “Për vullnetarizmin” pritet të ketë ndikime sociale të rëndësishme për vullnetarët. Shërbimi si vullnetarë vlerësohet i rëndësishëm nga pikëpamja sociale dhe personale, duke u lidhur me aspekte si zhvillimi i aftësive personale dhe aftësive për jetën; përmirësimi i mundësive për karrierë, reflektimi rreth aftësive në tregun e punës, si urë lidhëse ndërmjet studimeve dhe tregut të punës; nxitë empatinë, gjithëpërfshirjen dhe solidaritetin; krijon lidhje dhe socializim, forcon kapitalin social; përmirëson cilësinë e jetës dhe ndikon pozitivisht në lidhjen e ngushtë me komunitetin. Përmes opsionit të propozuar do të rriten mundësitë për zhvillimin e këtyre aspekteve nga pikëpamja shoqërore dhe personale, si dhe do të lehtësohen mekanizmat për njohjen e periudhës dhe kompetencave të fituara përmes vullnetarizmit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

1. Qartësi dhe integritet ligjor:

Ligji i ri do të përfshijë përkufizime të qarta dhe parime gjithëpërfshirëse që dallojnë vullnetarizmin nga marrëdhëniet juridike të tjera (punësimi, shërbimet e kontraktuara). Kjo shmang paqartësitë ekzistuese dhe siguron një bazë ligjore të qëndrueshme për aktivitetet vullnetare.

2. Harmonizimi ndërkombëtar:

Propozimi për një ligj të ri harmonizohet me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, në përputhje me rekomandimet e Këshillit Evropian për mobilitetin e vullnetarëve të rinj në BE.

3. Mekanizma modernë:

Ligji i ri do të krijojë një regjistër elektronik kombëtar për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve vullnetare. Ky mekanizëm do të përmirësojë transparencën, do të ulë kostot administrative dhe do të ndihmojë në matjen e ndikimit të aktiviteteve.

4. Mbrojtja e vullnetarëve:

Ligji do të përfshijë masa mbrojtëse për vullnetarët, duke përfshirë sigurimin nga aksidentet në punë dhe njohjen e përvojës vullnetare si përvojë pune.

5. Promovimi i vlerave sociale dhe solidaritetit:

Ligji do të përqendrohet në edukimin dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e vullnetarizmit, duke nxitur përfshirjen e të rinjve dhe grupeve vulnerabël në aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin personal dhe shoqëror.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Financimi	2025	2026	2027	2028
Total	0	25,440,000	21,440,000	21,440,000
Buxheti i shtetit	0	25,440,000	21,440,000	21,440,000
Të pambuluarra	-0	-0	0-	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsytet pse?)

Konteksti dhe qëllimi i konsultimeve

Rishikimi i Ligjit Nr. 45/2016 “Për Vullnetarizmin” u iniciua për të adresuar problematika të identifikuara gjatë zbatimit të tij dhe për të krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile dhe vullnetarizmin në Shqipëri. Procesi kishte për qëllim:

- Harmonizimin e ligjit me praktikat më të mira europiane.
- Rritjen e përfshirjes së të rinjve dhe organizatave në zbatimin e ligjit.
- Sigurimin e një kuadri ligjor që lehtëson dhe mbështet aktivitetet vullnetare.

Fazat kryesore të konsultimeve

1. Hapja e konsultimeve (2022-2023):

- Konsultime me përfaqësues të 11 organizatave të shoqërisë civile, pjesë e një koalicioni prej 39 organizatash, të cilat kërkonin ndryshime ligjore.
- Ngritja e Grupit Ndërinstitucional të Punës nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit Nr 9, datë 17.1.2024

2. Takimi në Konventën Kombëtare për Integrimin European (9 korrik 2024):

- Aktivitet me pjesëmarrjen e mbi 50 përfaqësuesve nga shoqëria civile, institucionet shtetërore dhe të rinj, për diskutime dhe dhënien e rekomandimeve.
- Ndarja e praktikave më të mira europiane në zbatimin e politikave për vullnetarizmin.

3. Turi i konsultimeve “Rinia ndryshon ligjet” (korrik 2024):

- Përfshirja e të rinjve nga 11 bashki përmes takimeve dhe një Bootcamp tre-ditor.
- Prezantimi i pyetësorëve dhe materialeve informuese përmes platformës Kahoot, për të lehtësuar marrjen e kontributeve nga të rinjtë.
- Mbi 50 organizata të shoqërisë civile si Partners for Albania, Beyond Barriers etj.
- 500 anëtarë të grupeve rinore (KVR) dhe të rinj nga bashkitë.

4. Rekomandimet kryesore:

- Përcaktimi i qartë i përkufizimeve për vullnetarizmin e strukturuar dhe masiv.
- Lehtësimi i procedurave administrative për organizatat ofruese të vullnetarizmit.
- Përfshirja e të rinjve në politikëbërje dhe njohja e eksperiencës vullnetare si aftësi profesionale.
- Numri i komentevet të marra nga takimet publike dhe me shkrim, prej të cilave 22 janë të pranuara plotësisht dhe 3 të pranuara pjesërisht.

5. Publikimi ne RENJKP.

- Projektligji u publikua në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP) nga data 18.11.2024 deri me datë 16.12.2024.
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/800>

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i ligjit për vullnetarizmin do të kryhet nga Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësim. Institucioni do të mbikëqyrë zbatimin, të analizojë raportet nga inspektimet dhe të hartojë rekomandime për përmirësimin e politikave. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë do të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar të vullnetarëve dhe do të trajtojë organizatat dhe vullnetarët mbi standardet ligjore dhe etike. Të dhënat dhe rekomandimet nga ky proces do të përdoren për të përmirësuar kuadrin dhe praktikën e vullnetarizmit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2016. Ky ligj synon rregullimin ligjor të veprimtarinë së vullnetarizmit, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale, përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe zhvillimin e

vlerave të solidaritetit njerëzor. Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet që kryejnë, përfitojnë ose ofrojnë vullnetarizëm në Republikën e Shqipërisë.

Vullnetarizmi në kuptimin e këtij ligji është investimi me vullnet të lirë i kohës, njohurive dhe aftësive për kryerjen e aktiviteteve ose shërbimeve nga vullnetari. Dispozitat e këtij Ligji rregullojnë dhe përcaktojnë gjithashtu kushtet, përmbajtjen dhe efektet e kontratës së vullnetarizmit, të drejtat dhe përgjegjësitë e vullnetarëve dhe ofruesit të vullnetarizmit.

Ligji aktual parashikon miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë mënyrën e organizimit, raportimit dhe dokumentimit të veprimtarive vullnetare, përkatësisht: miratimin e Kodit të Etikës së Vullnetarit me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe miratimin e Regjistrit të Vullnetarit dhe Librezës së Vullnetarit me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit. Aktualisht, janë miratuar aktet nënligjore:

- Vendim nr. 506, datë 17.07.2019 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit”;
- Urdhri nr. 229/2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Kartës së Vullnetarit”;
- Urdhri nr. 300/2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Vullnetarizmit”.

Aktualisht, të publikuara në Fletoren Zyrtare është vetëm VKM nr. 506, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit”. Ky kod synon të promovojë standarde të larta etike në marrëdhënien ndërmjet vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit. Ai përkufizon detyrimin për trajtim me dinjitet dhe respekt, ndalimin e çdo forme diskriminimi apo sjelljeje të papërshtatshme, si dhe garanton të drejtën e vullnetarit për informacion, përzgjedhje të lirisë së pozicionit, për zhvillim profesional dhe kushte të sigurt pune. Në thelb, vullnetarizmi konsiderohet si një kontribut i ndërgjegjshëm dhe i dobishëm për shoqërinë, që duhet të zhvillohet mbi bazën e barazisë, partneritetit dhe respektit të ndërsjellë.

Kodi përfshin gjithashtu dispozita të posaçme për procedurat e ankesave në rast shkeljeje të etikës, si dhe masat disiplinore që mund të merren ndaj vullnetarëve në raste të caktuara. Një pjesë e rëndësishme e këtij akti është edhe përcaktimi i rolit të ofruesit të vullnetarizmit, i cili ka për detyrë të sigurojë kushte të përshtatshme, mbështetje të vazhdueshme dhe respektim të të drejtave të vullnetarëve gjatë gjithë kohëzgjatjes së angazhimit të tyre.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyra e problemit

Ligji ekzistues për vullnetarizmin (Ligji Nr. 45/2016) ka treguar dobësi të theksuara në zbatimin e tij, duke penguar zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve vullnetare në Shqipëri. Problemi kryesor qëndron në mungesën e një kuadri të qartë dhe gjithëpërfshirës që rregullon marrëdhëniet vullnetare, mbështet organizatat ofruese dhe mbron të drejtat e vullnetarëve. Këto mangësi kanë krijuar një mjedis të fragmentuar dhe të pasigurt për të gjitha palët e përfshira.

Disa nga shkaqet kryesore të lidhura me problemin përfshijnë, si vijon:

1. **Rregullime të pamjaftueshme dhe përkufizime të paqarta ligjore:** Ligji aktual ofron përkufizime të paqarta dhe jo të standardizuara të vullnetarizmit dhe si rrjedhojë ka sjellë konfuzion në dallimin midis marrëdhënieve vullnetare dhe formave të tjera juridike, si punësimi.
2. **Mungesa e mekanizmave mbështetës dhe monitorues:** Aktualisht, nuk ekziston një sistem i centralizuar funksional për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve vullnetare në nivel kombëtar, pavarësisht parashikimeve ligjore për krijimin e një regjistri të tillë. Kjo mungesë ka sjellë vështirësi në evidentimin dhe dokumentimin e organizatave që ofrojnë veprimtari vullnetare, si dhe të vetë vullnetarëve të përfshirë në këto procese. Si rrjedhojë, ka krijuar mungesë transparence dhe llogaridhënie.
3. **Pjesëmarrje e ulët për shkak të mungesës së stimuljeve:** Vullnetarizmi nuk njihet si përvojë e vlefshme profesionale, gjë që dekurajon pjesëmarrjen e të rinjve dhe grupeve të tjera.
4. **Mbrojtje e pamjaftueshme për vullnetarët:** Nuk janë parashikuar masa të plota për sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen, duke krijuar pasiguri për individët që angazhohen në aktivitete vullnetare.
5. **Promovim dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm:** Nuk ekzistojnë fushata sistematike për të promovuar vlerat dhe përfitimet e vullnetarizmit në nivel kombëtar.

Shtrirja e problemit:

Problemi është i evidentuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe prek të gjitha format e vullnetarizmit, nga angazhimi i të rinjve deri tek organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe humanitare. Mungesa e një sistemi mbështetës dhe qartësia e kufizuar ligjore kanë krijuar pengesa për:

1. **Qytetarët, veçanërisht të rinjtë dhe grupet e veçanta-** pasi mungon siguria dhe informacioni i qartë lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen gjatë përfshirjes në aktivitete vullnetare.
2. **Shoqëritë civile** – organizatat që ofrojnë vullnetarizëm përballen me pengesa administrative, mungesë të kapaciteteve dhe mbështetjes institucionale për organizimin dhe menaxhimin efektiv të veprimtarive vullnetare.
3. **Qeveria dhe institucionet publike-** institucionet publike që kanë përgjegjësi për zbatimin e ligjit.
4. **Bizneset-** përfitimi i kufizuar nga vlera e shtuar që mund të ofrojnë aktivitetet vullnetare në zhvillimin e shërbimeve komunitare dhe përgjegjësisë sociale të bizneseve.

Vlerësimi i trajtimit të problemit përmes ndryshimit të politikave Problemi mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes zbatimit të politikave të reja, me qëllim adresimin e të gjitha problematikave të hasura gjatë zbatimit të vullnetarizmit. Këto ndryshime mund të përfshijnë:

- Përcaktimin e qartë të koncepteve dhe parimeve të vullnetarizmit.
- Krijimin e një sistemi të centralizuar për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve.
- Sigurimin e një mbrojtje për vullnetarët dhe stimuj për pjesëmarrje.
- Promovimin e ndërgjegjësimit dhe njohjes së vullnetarizmit si përvojë profesionale dhe shoqërore.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve do të mundësojë ndërtimin e një kuadri funksional institucional dhe rregullator në fushën e vullnetarizmit, duke garantuar mbrojtjen e vullnetarëve dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive qytetare. Një qasje e tillë do të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të veprimtarive vullnetare dhe përfshirjen e gjerë të të rinjve dhe grupeve të tjera në shërbim të komunitetit dhe interesit publik.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për të përmirësuar kuadrin ligjor që rregullon vullnetarizmin dhe për të garantuar që çdo individ, veçanërisht të rinjtë, të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar, zhvilluar aftësi dhe përfituar nga angazhimi qytetar. Aktualisht, kuadri ligjor ekzistues nuk ofron mbrojtje dhe mbështetje të mjaftueshme për vullnetarët, duke përfshirë dhe vullnetarët që i përkasin grupeve të veçanta.

Qeveria synon të trajtojë disa çështje kryesore përmes:

1. Qartësimin e kuadrit ligjor, duke ofruar përkufizime të sakta për vullnetarizmin dhe aktorët e përfshirë në të.
2. Krijimin e mekanizmave mbështetës, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të strukturuar regjistrimi dhe monitorimi që rrit transparencën dhe llogaridhënien.
3. Sigurimin e mbrojtjes për vullnetarët, duke garantuar masa mbrojtëse dhe sigurime për shëndetin dhe sigurinë gjatë angazhimit të tyre vullnetar.
4. Rritjen e pjesëmarrjes qytetare, me theks të veçantë te të rinjtë dhe grupet e veçanta, përmes nxitjes së angazhimit në aktivitete vullnetare.
5. Promovimin dhe njohjen e vullnetarizmit, përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit mbi vlerat e tij dhe njohjes së kontributit vullnetar si përvojë pune të vlefshme.

Ndërhyrja e qeverisë duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë disa nivele:

- Në nivel legjislativ: Miratimi i ndryshimeve në ligjin për vullnetarizmin dhe i akteve nën ligjore të tij, për të adresuar mangësitë e identifikuar.

- Në nivel qendror: Krijimi i mekanizmave të reja dhe forcimi i strukturave ekzistuese për zbatimin e ligjit, në të cilën përfshihet regjistri elektronik kombëtar për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve.
- Në nivel vendor: Rritja e rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore në ndërgjegjësimin e komunitetit, mbështetjen dhe financimin e veprimtarive vullnetare, si dhe përfshirjen aktive në krijimin e kushteve lehtësuese për nismat lokale të vullnetarizmit.

Kjo nismë është në përputhje me objektivat strategjike të qeverisë shqiptare, të cilët përfshijnë:

- **Përfshirja sociale dhe fuqizimi i qytetarisë aktive:** Nxitja e pjesëmarrjes qytetare përmes vullnetarizmit kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të përfshirë dhe të përgjegjshme.
- **Përmirësimi i shërbimeve sociale** Vullnetarizmi mbështet zbatimin e politikave sociale dhe mjedisore, duke krijuar një ndikim pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm. Vullnetarët mund të ndihmojnë në qendrat komunitare për fëmijët në nevojë, duke ofruar ndihmë në mësim, aktivitete edukative dhe mbështetje emocionale. Kjo përmirëson aksesin dhe cilësinë e shërbimeve sociale për kategori vulnerabël, edhe në zona ku shteti ka mungesë burimesh.
- **Harmonizimi me standardet e BE-së:** Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të Bashkimit Evropian. Megjithatë, projektligji është harmonizuar me rekomandimin e Këshillit Evropian, të datës 5 Prillit 2022, për Mobilitetin e Vullnetarëve të rinj në BE (2022/C 157/01). Gjithashtu, projektligji ishte pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, parashikuar për t'u miratuar gjatë katër mujorit të III-të të vitit 2024, në zbatim të vendimit nr. Vendimin nr. 790, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekteve që do të paraqiten për shqyrtim në këshillin e ministrave gjatë vitit 2024". Akti është i parashikuar në PKIE 2025-2027, në grupkapitullin 3, "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse"
- Gjithashtu në referim të **Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029**, në Qëllimin Politik 1, i cili është i lidhur me fuqizimin e të rinjve, 1 ndër Objektivat Specifikë të SKR, ka parashikuar, konkretisht: Objektivi Specifik 1.1 : Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike dhe masa konkrete : 1.8. Rishikohet ligji "Për vullnetarizmin" me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve.

Puna ekzistuese e realizuar:

Deri më tani, disa hapa janë ndërmarrë në kuadër të rritjes së vullnetarizmit:

- Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin";
- Organizimi i konsultimeve publike me të rinjtë, organizata të shoqërisë civile, për të marrë mendime dhe rekomandime mbi përmirësimin e këtij aktiviteti. .

Me gjithë hapat e ndërmarra dhe rezultatet e arritura deri më tani, puna e kryer nuk ka qenë e mjaftueshme për të adresuar plotësisht sfidat ekzistuese dhe për të garantuar një mbrojtje dhe mbështetje gjithëpërfshirëse për të gjithë individët e përfshirë në veprimtari vullnetare në Shqipëri.

Nga pikëpamja e realizimit të aktiviteteve në fushën e vullnetarizmit, ka patur iniciativa individuale nga aktorë të ndryshëm si organizata të shoqërisë civile, qytetarë etj.

Mobilizimi qytetar dhe vullnetar gjatë situatave emergjente tregoi që është një model i sukseshëm i bashkëpunimit në dobi të komunitetit dhe në ndihmë të grupeve në nevojë. Përballja me tërmetin e 25 nëntorit 2019 dhe po ashtu situata emergjente e krijuar prej masave të ndërmarra për parandalimin e virusit Covid-19, tregoi që kontributi i vullnetarëve ishte tejet i rëndësishëm në kapërcimin e këtyre sfidave. Kjo është një përvojë pozitive e angazhimit qytetar vullnetar në situata emergjente.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat strategjikë të politikës janë:

- Qartësimi i kuadrit ligjor;
- Nxitja dhe promovimi i vullnetarizmit;
- Rritja e mbrojtjes së vullnetarëve;
- Nxitja e pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjes sociale.

Objektivat specifik të politikës:

1. Rritja e qartësisë dhe harmonizimit të kuadrit ligjor të zbatueshëm në këto fusha brenda vitit 2025.;
2. Të krijohet një sistem kombëtar regjistrimi për vullnetarët dhe organizatat vullnetare, i cili të mundësojë gjenerimin e të dhënave statistikore vjetore deri në fund të vitit 2026;
3. Të vendoset një mekanizëm për njohjen zyrtare të përvojës vullnetare, duke garantuar lëshimin e certifikatave të përvojës deri në fund të vitit 2026 dhe organizimin e të paktën pesë fushatave kombëtare të promovimit deri në vitin 2028.
4. Të rritet mbrojtja e vullnetarëve të regjistruar dhe sigurimi i aksesit për 80% të vullnetarëve deri në fund të 2027.
5. Të rritet numri i vullnetarëve të regjistruar në nivel kombëtar, duke arritur në të paktën 30,000 individë deri në vitin 2028, prej të cilëve të paktën 40% të jenë të rinj dhe 10% të përfaqësojnë grupe të veçanta.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*

- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Nga shqyrtimi i opsioneve të mëposhtme rezulton:

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0: Status quo (Ruajtja e kuadrit aktual ligjor)

Opsioni i status quo-së përfaqëson mosndryshimin e Ligjit ekzistues Nr. 45/2016 për Vullnetarizmin. Ky opsion nënkupton mbajtjen e kuadrit aktual ligjor dhe vazhdimin e praktikave ekzistuese të rregullimit të aktiviteteve vullnetare, pa bërë përmirësime ose ndryshime thelbësore.

- **Përparësi të opsionit status quo:**
 - Nuk kërkon shpenzime shtesë për ndryshime ligjore dhe zbatimin e tyre.
 - Ruhet struktura ekzistuese e përgjegjësi dhe procedurave për vullnetarizmin.
- **Kufizime të opsionit status quo:**
 - Problemet aktuale mbeten të pazgjidhura, duke përfshirë mungesën e qartësisë ligjore, mekanizmave mbështetës dhe njohjes së përvojës vullnetare.
 - Nuk adresohen barrierat për rritjen e pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së vullnetarëve.
 - Shoqëria civile dhe organizatat e vullnetarizmit përballen me sfida të vazhdueshme për zbatimin dhe mbështetjen e aktiviteteve vullnetare.

Për shkak të këtyre kufizimeve, opsioni i status quo-së konsiderohet i pamjaftueshëm për të përmbushur objektivat e politikës dhe për të adresuar nevojat e identifikuara.

Opsioni 1: Amendimi i Ligjit ekzistues Nr. 45/2016

Amendimi i Ligjit ekzistues për vullnetarizmin përfshin rishikimin dhe përmirësimin e disa dispozitave të tij për të adresuar problemet aktuale. Ky opsion nënkupton ndryshime të pjesshme në ligj, duke ruajtur strukturën bazë të kuadrit aktual.

- **Elementët kryesorë të amendimit:**
 - Qartësimi i përkufizimeve të vullnetarizmit dhe dallimit të tij nga marrëdhëniet e tjera juridike.
 - Futja e disa mekanizmave për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve vullnetare.
 - Shtimi i dispozitave për mbrojtjen shëndetësore dhe sigurimin nga aksidentet për vullnetarët.
- **Përparësitë e amendimit:**
 - Ofron një përmirësim të kuadrit ekzistues pa kërkuar rishikime tërësore.
 - Zbatimi i tij është më i lehtë dhe me kosto më të ulët.
- **Kufizimet e amendimit:**

- Krijohet nevoja për ndryshime të mëtejshme në të ardhmen, duke shtuar kompleksitet në zbatimin e politikave
- Ndryshimet mund të prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit aktual, duke e bërë të papërshtatshëm kete opsion.

Opsioni 2: Hartimi i një Ligji të Ri për Vullnetarizmin (Opsioni i preferuar)

Ky opsion përfshin krijimin e një ligji të ri që zëvendëson plotësisht kuadrin aktual ligjor, duke rregulluar të gjitha aspektet e vullnetarizmit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.

- **Elementët kryesorë të ligjit të ri:**
 - Përkufizime të qarta dhe të zgjeruara për vullnetarizmin dhe aktorët e përfshirë.
 - Krijimi i një regjistri elektronik kombëtar për vullnetarizmin për të mundësuar regjistrimin dhe monitorimin.
 - Përfshirja e masave mbrojtëse për vullnetarët, përfshirë sigurimin shëndetësor dhe nga aksidentet.
 - Dhënia e certifikatave për njohjen e përvojës vullnetare si përvojë pune dhe zhvillimi i mekanizmave të promovimit.
- **Përparësitë e ligjit të ri:**
 - Adreson të gjitha sfidat dhe kufizimet e identifikuara në mënyrë gjithëpërfshirëse.
 - Harmonizohet me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE-së.
 - Rrit pjesëmarrjen qytetare dhe garanton mbështetje të qëndrueshme për organizatat dhe individët.
- **Kufizimet e ligjit të ri:**
 - Kërkon kohë dhe burime të konsiderueshme për hartimin dhe zbatimin.
 - Mund të krijojë sfida në periudhën tranzitore nga legjislacioni aktual në kuadrin e ri.

Opsioni 3: Ndërhyrja nëpërmjet masave jorregullatore

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në veprimtari vullnetare;
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për organizatat e shoqërisë civile që të përfshijnë të rinjtë në veprimtari vullnetare;
- Edukimi nëpërmjet organizimit të trajnimeve për qytetarët mbi të drejtat e tyre, mundësitë për përfshirje sociale dhe politike, si dhe përfitimet nga angazhimi në organizata rinore.
- Nxitja e bashkëpunimit midis qeverisë, organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit privat për të krijuar mundësi të qëndrueshme për vullnetarizëm dhe për të mbështetur nisma që angazhojnë të rinjtë në veprimtari vullnetare.
- Nxitja e pjesëmarrjes në nivel vendor.

Ky opsion paraqet disa avantazhe në krahasim me opsionet e tjera, ndër të cilat koha më e shkurtër për ta zbatuar. Megjithatë disavantazhi kryesor është pamundësia e zgjidhjes së problemeve që kërkojnë ndërhyrje rregullatore për t'u trajtuar në mënyrë të përshtatshme. Për këtë arsye nuk mundëson arritjen e të gjitha objektivave të vendosura dhe nuk mund të zgjidhet si opsion i preferuar.

Pse u zgjodhën këto opsione?

Opsionet e shqyrtuara janë zgjedhur për të adresuar problemet dhe nevojat e identifikuara në kuadrin aktual ligjor, duke marrë parasysh qasjet e mundshme:

1. **Opsioni i status quo-së** është përfshirë si një pikë krahasimi për të vlerësuar nëse ndërhyrja është e nevojshme dhe efektive.
2. **Opsioni i amendimit** është shqyrtuar si një qasje që synon përmirësime të pjesshme, duke ruajtur strukturën aktuale.
3. **Opsioni i hartimit të një ligji të ri** është propozuar si një zgjidhje gjithëpërfshirëse që reflekton nevojën për një transformim tërësor dhe të qëndrueshëm të kuadrit ligjor.
4. **Opsioni jo rregullator.**

Këto opsione janë analizuar bazuar në qëllimet e politikës, realizueshmërinë dhe potencialin për të adresuar problemet në mënyrë efektive. Opsioni i preferuar, **hartimi i një ligji të ri**, është zgjedhur për shkak të potencialit të tij për të krijuar një mjedis mbështetës, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar për zhvillimin e vullnetarizmit në Shqipëri.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Ndërhyrja prek një gamë e gjerë aktorësh, përfshirë:

1. **Qeveria dhe institucionet publike:** Përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e ligjit.
2. **Shoqëria civile dhe organizatat e vullnetarizmit:** Përfituese nga mbështetja dhe rregullimi i aktiviteteve vullnetare.
3. **Vullnetarët:** Përfitues të masave mbrojtëse dhe stimuljve të rinj për përfshirje.

4. **Qytetarët dhe grupet e veçanta:** Përfitues nga aktivitetet dhe projektet vullnetare.
5. **Bizneset dhe komuniteti:** Përfituese indirekte nga zhvillimi i përgjegjësisë sociale dhe shërbimeve komunitare.

Llojet e ndikimeve:

1. Ndikimet e drejtpërdrejta përfshijnë:

- **Qeveria dhe institucionet publike:**
 - Kosto financiare dhe logjistike për krijimin e regjistrit elektronik dhe monitorimin e ligjit. Kosto për promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve. Sipas parashikimeve buxhetore në programin “Tregu i Punës” pranë AKPA, parashikimet janë si vijon: 25,440,000 për vitin 2026, 21,440,000 për vitin 2027 dhe 21,440,000 për vitin 2028. Keto kosto kane parashikuar investime si pershtatja e portalit zyrtar të punësimit dhe aftësive për perfshirjen e platformes elektronike të vullnetarizimit, Regjistrin Elektronik të Vullnetarizimit, si dhe projekte të tjera si: rimbursimi i sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale për 1000 vullnetare, financimi i programeve të vullnetarizimit dhe cmimet e vullnetareve të vitit.
 - Përfitimet që parashikohet të rrjedhin nga ky kontribut financiar pritet të jenë për 3 kategori: për individët vullnetarë, që fitojnë praktikë vullnetare, kompetenca ndërpersonale dhe profesionale që rrisin mundësinë e punësimit; shoqëria civile që përfiton rritje të kapaciteteve dhe mundësive për mbështetje; si dhe qytetarët dhe grupet e veçanta të cilët përfitojnë nga ky kontribut i rëndësishëm që gjeneron vlerë ekonomike duke ulur kosot për shërbime sociale dhe edukative.

Keto përfitime pritet të vijne kryesisht nga:

- Rimbursimi i sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale (1000 vullnetare) = 1,440,000 lekë.
 - Financim i programeve të vullnetarizimit = 15,000,000 lekë.
 - Cmimet e vullnetareve të vitit (lump sum) = 5,000,000 lekë.
- Përgjegjësi shtesë për zbatimin dhe mbikëqyrjen.
- **Shoqëria civile dhe organizatat e vullnetarizimit:**
 - Reduktim i barrës administrative përmes regjistrit elektronik dhe qartësimit të procedurave.
 - Mbështetje institucionale dhe ligjore për veprimtarinë e tyre.
- **Vullnetarët:**
 - Siguri më e madhe përmes masave mbrojtëse dhe njohjes së përvojës vullnetare si përvojë pune.
 - Motivim shtesë për përfshirje.

2. Ndikimet jo të drejtpërdrejta

- **Qytetarët dhe grupet e veçanta:**
 - Rritja e përfshirjes në aktivitete sociale dhe zhvillim profesional.

- Fuqizimi i komuniteteve përmes projekteve të vullnetarizmit.
- **Bizneset dhe komuniteti:**
 - Përmirësimi i imazhit të biznesit përmes projekteve të përgjegjësisë sociale të realizuara nga vullnetarët.

Ndikimet cilësore jo të drejtpërdrejta

1. **Sociale:** Rritja e solidaritetit dhe bashkëpunimit në shoqëri. Fuqizimi i grupeve të veçanta dhe përmirësimi i aksesit të tyre në shërbime dhe mundësi.
2. **Ekonomike:** Vullnetarizmi mund të ndikojë në përmirësimin e aftësive profesionale të individëve, duke ndihmuar në uljen e papunësisë dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.
3. **Kulturore dhe mjedisore:** Aktivitetet vullnetare mund të mbështesin projekte për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.

Ndikimi mbi konkurrencën:

.Përmes standardizimit të procedurave dhe vendosjes së një kuadri të unifikuar ligjor, projektligji synon të rrisë cilësinë dhe barazinë në ofrimin e aktiviteteve vullnetare. Ky rregullim i ri do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi më transparent, të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjitha organizatat që veprojnë në fushën e vullnetarizmit. Si rrjedhojë, pritet të përmirësohet konkurrenca cilësore mes organizatave, duke nxitur përmirësimin e praktikave të ofrimit të vullnetarizmit, rritjen e besueshmërisë dhe profesionalizmit në realizimin e aktiviteteve vullnetare, si dhe zgjerimin e aksesit për grupet përfituese.

Kufizimet e analizës:

1. **Supozimet e përdorura dhe risqet përkatëse:**
 - Supozohet që institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile do të kenë kapacitetin dhe burimet për të zbatuar ndryshimet. Një mungesë e tillë mund të pengojë realizimin e përfitimeve.
 - Financimi i regjistrat elektronik dhe programeve të promovimit mund të jetë i kufizuar nga buxheti publik.
2. **Forca dhe pavarësia e provave mbështetëse:**
 - Konsultimet publike dhe raportet ekzistuese për zbatimin e ligjit aktual ofrojnë një bazë të fortë për propozimin e ligjit të ri.
 - Raste të ngjashme nga vende të tjera evropiane mbështesin idenë që një kuadër i përmirësuar ligjor për vullnetarizmin është efektiv.
3. **Pengesa dhe rreziqe të mundshme:**
 - Vonesa në ngritjen e infrastrukturës mbështetëse (p.sh., regjistri elektronik).
 - Vështirësi në koordinimin ndër-institucional dhe midis organizatave për zbatimin e ligjit.

Kosto e parashikuar do të mbulohet brenda tavaneve buxhetore të programit “Tregu i punës”, të alokuara në buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive AKPA.

Keto kosto kane parashikuar investime si pershtatja e portalit zyrtar te punesimit dhe aftesive per perfshirjen e platformes elektronike te vullnetarizmit, Regjistrin Elektronik te Vullnetarizimit, si dhe projekte te tjera si: rimbursimi i sigurimit te aksidenteve dhe semundjeve profesionale per 1000 vullnetare, financimi i programeve te vullnetarizimit dhe cmimet e vullnetareve te vitit.

Shpjegimi i krahasimit të opsioneve

Përlllogaritjet neto të ndikimeve (në lekë)

Opsioni	Kosto (në lekë)	Përfitime monetare	Përfitime neto
Opsioni 0: Status quo	0	0	0
Opsioni 1: Amendimi	0	0	0
Opsioni 2: Ligji i ri	62,248,000	58,437,000	3,811,000
Opsioni 3: Jo rrgullator	0	0	0

(*Përfitimet priten të rriten pas vitit të parë për shkak të rritjes së pjesëmarrjes dhe ndikimeve afatgjata.) Opsioni i preferuar, hartimi i një ligji të ri, është më i përshtatshëm për të siguruar qëndrueshmëri dhe efektivitet në zhvillimin e vullnetarizmit, duke garantuar përfitime të konsiderueshme në periudhën afatgjatë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i status quo-së është më i lehtë për t'u zbatuar, por nuk adreson problemet aktuale. Opsioni i amendimit ofron një përmirësim të pjesshëm, por mund të mos arrijë objektivat e plotë. Opsioni i preferuar, hartimi i një ligji të ri, ofron një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë për zhvillimin e vullnetarizmit, megjithëse kërkon burime më të mëdha financiare dhe kohë për implementim. Janë analizuar kriteret si më poshtë vijon:

1. Qartësi dhe integritet ligjor:

Ligji i ri do të përfshijë përkufizime të qarta dhe parime gjithëpërfshirëse që dallojnë vullnetarizmin nga marrëdhëniet juridike të tjera (punësimi, shërbimet e kontraktuara). Kjo shmanë paqartësitë ekzistuese dhe siguron një bazë ligjore të qëndrueshme për aktivitetet vullnetare.

2. Harmonizimi ndërkombëtar:

Propozimi për një ligj të ri harmonizohet me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, në përputhje me rekomandimet e Këshillit Evropian për mobilitetin e vullnetarëve të rinj në BE.

3. Mekanizma modernë:

Ligji i ri do të krijojë një regjistrë elektronik kombëtar për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve vullnetare. Ky mekanizëm do të përmirësojë transparencën, do të ulë kostot administrative dhe do të ndihmojë në matjen e ndikimit të aktiviteteve.

4. Mbrojtja e vullnetarëve:

Ligji do të përfshijë masa mbrojtëse për vullnetarët, duke përfshirë sigurimin nga aksidentet në punë dhe njohjen e përvojës vullnetare si përvojë pune.

5. Promovimi i vlerave sociale dhe solidaritetit:

Ligji do të përqendrohet në edukimin dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e vullnetarizmit, duke nxitur përfshirjen e të rinjve dhe grupeve vulnerabël në aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin personal dhe shoqëror.

6.Kosto efektiviteti:Realizimi i aktiviteteve të vullnetarizmit në përputhje me tavanet buxhetore të institucioneve përgjegjëse

<u>Kriteret</u>	<u>Pesha</u>	<u>Opsioni 0</u>		<u>Opsioni 1</u>		<u>Opsioni 2</u>		<u>Opsioni 3</u>	
	<u>(Rëndësi a relative)</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera</u>	<u>Pikë</u>	<u>Vlera</u>
	-	-	<u>(=Pesh a x pikë)</u>	-	<u>(=Pesh a x pikë)</u>	-	<u>(=Pesh a x pikë)</u>	-	<u>(=Pesh a x pikë)</u>
Qartësi dhe integritet ligjor	<u>3</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>1</u>	<u>3</u>	<u>5</u>	15	<u>1</u>	3
Harmonizimi ndërkombëtar	<u>3</u>	<u>0</u>	0	<u>1</u>	<u>3</u>	5	15	2	6
Mekanizma modernë regjistra elektronike	<u>3</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>2</u>	<u>6</u>	<u>4</u>	12	<u>1</u>	3
Mbrojtja e vullnetarëve	<u>4</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>2</u>	<u>8</u>	<u>4</u>	16	<u>2</u>	8
Promovimi i vlerave sociale dhe solidaritetit	<u>4</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>1</u>	<u>4</u>	<u>5</u>	20	<u>2</u>	8
Kosto efektiviteti	<u>3</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>1</u>	<u>3</u>	<u>4</u>	12	<u>1</u>	3

Pikët totale për secilin opsion	-	<u>0</u>	-	<u>27</u>	-	<u>90</u>	-	<u>31</u>
--	---	----------	---	-----------	---	-----------	---	-----------

Opsioni i preferuar: Bazuar në analizën e opsioneve dhe vlerësimin e ndikimeve, **hartimi i një ligji të ri për vullnetarizmin** është zgjedhur si opsioni i preferuar. Ky opsion siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë për adresimin e problemeve aktuale dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve vullnetare në Shqipëri.

Arsyetimi i zgjedhjes:

1. Adresimi i plotë i problemeve aktuale:

- Ligji i ri do të zgjidhë mangësitë e Ligjit Nr. 45/2016, duke përfshirë përkufizimet e paqarta, mungesën e mekanizmave mbështetës dhe pasigurinë për vullnetarët.
- Do të krijojë një kuadër modern që ndan qartë vullnetarizmin nga marrëdhëniet e tjera juridike dhe rrit mbështetjen për të gjitha palët e përfshira.

2. Përfitime sociale dhe ekonomike afatgjata:

- Ligji do të nxisë rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe fuqizimin e grupeve të veçanta përmes mbështetjes së projekteve vullnetare.
- Njohja e përvojës vullnetare si përvojë pune do të ndihmojë në zhvillimin profesional dhe fuqizimin e kapitalit njerëzor.

3. Harmonizimi me standardet ndërkombëtare:

- Hartimi i një ligji të ri përputhet me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian dhe objektivat kombëtare për integrim evropian, duke garantuar standarde të larta për mbrojtjen dhe promovimin e vullnetarizmit.

4. Krijimi i mekanizmave modernë:

- Regjistri elektronik kombëtar për vullnetarizmin dhe mekanizmat e monitorimit do të sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie, duke lehtësuar regjistrimin dhe raportimin e aktiviteteve.
- Promovimi përmes fushatave ndërgjegjësimi dhe mbështetja financiare për organizatat do të kontribuojnë në rritjen e pjesëmarrjes.

5. Qëndrueshmëria dhe ndikimi pozitiv afatgjatë:

- Ndërsa kërkon më shumë burime financiare dhe kohë për implementim, ligji i ri pritet të gjenerojë përfitime të ndjeshme sociale dhe ekonomike në periudhën afatgjatë.
- Në krahasim me opsionin e amendimit, ligji i ri ofron zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe adreson të gjitha aspektet e vullnetarizmit në mënyrë të qëndrueshme.

Hartimi i një ligji të ri për vullnetarizmin është opsioni më i përshtatshëm për të krijuar një kuadër ligjor që mbështet dhe promovon vullnetarizmin si një vlerë shoqërore dhe një instrument për zhvillimin personal dhe ekonomik. Ky opsion siguron që Shqipëria të përmbushë prioritetet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës për të gjithë aktorët e përfshirë.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Njësia përgjegjëse për zbatimin:

- **Ministria përgjegjëse për Punësimin dhe Institucione të Tjera Përgjegjëse:** Sipas projektligjit, zbatimi do të koordinohet nga ministria përgjegjëse për punësimin, në bashkëpunim me institucionin përgjegjës për punësimin dhe aftësitë) dhe institucionet e tjera të linjës si Ministria përgjegjëse për Rininë, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Pengesat e mundshme për zbatim:

- **Paaftësi institucionale dhe burime të kufizuara:** Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare mund të pengojë implementimin efektiv të ndryshimeve.
- **Kostot shtesë për organizatat:** Regjistrimi i vullnetarëve dhe mbajtja e regjistrave mund të jetë ngarkesë administrative për organizatat e vogla.

Masat për të arritur qëllimet e politikës:

- **Harmonizimi ligjor:** Përditësimi i kuadrit ekzistues për të qartësuar përkufizimet, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve.
- **Financim i dedikuar:** Krijimi i një fondi specifik për nxitjen e vullnetarizmit, duke mbështetur organizatat dhe individët që ofrojnë shërbime.
- **Ndërgjegjësimi dhe edukimi:** Organizimi i fushatave për të informuar publikun dhe grupet e interesit mbi përfitimet dhe detyrimet e vullnetarizmit.
- **Mbështetje teknike dhe trajnime:** Ofrimi i udhëzimeve dhe trajnimeve për organizatat që implementojnë ligjin.

Kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit:

- **Regjistri Kombëtar i Vullnetarëve:** Mirëmbajtja dhe administrimi i një regjistri online për mbledhjen e të dhënave mbi vullnetarizmin.
- **Certifikimi dhe standardet:** Krijimi i një mekanizmi për certifikimin e përvojave të fituara gjatë aktiviteteve vullnetare.
- **Mbikëqyrja institucionale:** Ministria përgjegjëse për punësimin dhe institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë do të monitorojnë zbatimin dhe do të analizojnë të dhënat e marra nga regjistri dhe raportet.

Në përputhje me të gjitha këto elemente, drafti aktual propozon një qasje gjithëpërfshirëse për të adresuar pengesat ekzistuese dhe për të siguruar suksesin e reformës.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Masat e monitorimit dhe vlerësimit

- Monitorimi institucional: Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë do të jetë përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga regjistri kombëtar i vullnetarëve dhe raportet vjetore nga organizatat ofruese të vullnetarizmit.
- Raportimi i përvitshëm: Ministria përgjegjëse për punësimin dhe institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë do të hartojnë raporte periodike për progresin dhe efektet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë sfidat dhe rekomandimet për përmirësime.
- Konsultime me aktorët e interesit: Përfshirja e organizatave jofitimprurëse dhe përfituesve për të mbledhur feedback mbi zbatimin e ligjit dhe për të identifikuar problematika të mundshme.
- Auditimi dhe inspektimi: Kontroll i zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore përmes inspektimeve të rregullta në organizatat ofruese të vullnetarizmit.

Kriteret dhe treguesit për matjen e progresit dhe arritjes së qëllimeve

- Rritja e numrit të organizatave që ofrojnë shërbime vullnetarizmi dhe janë pjesë e regjistrat elektronik të vullnetarizmit.
- Rritja e numrit të vullnetarëve të angazhuar, përfshirë ndarjen sipas grupmoshave, gjinive dhe llojeve të vullnetarizmit (afatshkurtër dhe afatgjatë).
- Rritja e numrit të programeve të financuara dhe shuma e alokuar për aktivitetet vullnetare nga fondet shtetërore dhe donatorët.
- Rritja e nivelit të kënaqësisë së pjesëmarrësve dhe përfituesve të vullnetarizmit mbi efektivitetin dhe ndikimin.
- **Niveli i harmonizimit ligjor:** Në kuadër të direktivave të BE-së, synohet marrja dhe përshtatja e praktikave më të mira të BE-së, në mënyrë që të kemi vullnetarizëm sa më gjithëpërfshirës dhe sa më me ndikim për komunitetin.
- Përputhshmëria e rregullimeve ligjore me kuadrin kombëtar dhe direktivat e BE-së për mobilitetin e vullnetarëve.
- **Numri i raporteve të vlerësimit:** Hartimi i raporteve të përvitshme për progresin dhe sfidat në zbatimin e ligjit.
- Rritja e numrit të vullnetarëve të cilëve i është njohur periodua e vullnetarizimit si pervojë pune.

Masat e monitorimit dhe vlerësimit do të jenë kyçe për të siguruar që po zbatohen objektivat e politikave në mënyrë efektive dhe për të bërë korrigjimet e nevojshme gjatë procesit të zbatimit. Indikatorët e performancës do të ndihmojnë në vlerësimin e ndikimit të politikave dhe në sigurimin e një qasjeje të bazuar në prova për përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor për vullnetarizmin.

Raporti i vlerësimit të ndikimit – Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në mijë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Shifrat në tabelë janë të shprehura në mijë (000) Lekë.

	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034
--	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------

Faktori zbritës	1	0.952 8	0.907 8	0.865	0.824 2	0.785 3	0.748 3	0.713 05	0.679 42	0.647 37
Kosto për buxhetin – njëhere	0	25.44 0	21.44 0	21.44 0						
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	0	25.44 0	21.44 0	21.44 0						
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	0	24.23 9	19.46 3	18.54 6						
Përfitimi për buxhetin										

n – në vazhdi m										
Përfitim i për biznesin – njëherë										
Përfitim i për biznesin – në vazhdi m										
Përfitim i për grupet e tjera – njëherë	0	21.44 0	21.44 0	21.44 0						
Përfitim i për grupet e tjera – në vazhdi m										
Përfitim për buxheti n – në vazhdi m *										
Përfiti mi në total	0	21.44 0	21.44 0	21.44 0						
Përfiti mi i zbritur në total = Përfitim i në total x faktorin zbritës	0	20.42 8	19.46 3	18.54 6						
Vlera aktuale e kostos në total	62.24 8									

Vlera aktuale e përfitimit në total	58.437
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	3.811

Shënim: Kosto “Kosto për buxhetin – një herë”, janë kosto nga buxheti I shtetit në përputhje me PBA 2026-2028, qe do depozitohet ne gusht, brenda tavaneve buxhetore te programit “Tregu i punes. Sipas parashikimeve buxhetore në programin “Tregu i Punës” pranë AKPA, parashikimet janë si vijon: 25,440,000 për vitin 2026, 21, 440,000 për vitin 2027 dhe 21,440,000 per vitin 2028. Keto kosto kane parashikuar investime si pershtatja e portalit zyrtar te punesimit dhe aftesive per perfshirjen e platformes elektronike te vullnetarizmit, Regjistrin Elektronik te Vullnetarizimit, si dhe projekte te tjera si: rimbursimi i sigurimit te aksidenteve dhe semundjeve profesionale per 1000 vullnetare, financimi i programeve te vullnetarizimit dhe cmimet e vullngtareve te vitit.

Përfituesit nga hyrja në fuqi dhe zbatimi i këtij projektiligji do të jenë :

- Individët vullnetarë (të cilët do të mund të shprehin interesin e tyre për angazhimin në veprimtari vullnetare nëpërmjet platformës elektronike të vullnetarizmit, do të vleresohen me çmimin e vullnetarit, etj sipas përcaktimeve në këtë projektiligj)
- Ofruesit pranë të cilëve do të ushtrohet veprimtaria vullnetare. Këto subjekte do të subvencionohen dhe rimbrusohen, për shpenzimet që do të kryejnë në kryerjen e programit të vullnetarizmit sipas përcaktimeve në këtë projektiligj).

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 2: Ligji i ri	62,248	58,437	3,811

